

Tirane, me 5 Qershor 2015

Lenda: Perfshirja ne skemat mbeshtetese te AZHBR, SARED te rrjetave antibresher ne pemetoret e molles

Situata: Rajoni i Korces eshte prodhuesi kryesor i molles ne vend, disponon mbi 2500 ha dhe prodhimi i 2014 ka qene mbi 60 mije ton qe perben rreth 65 % te prodhimit ne nivel kombetar. Molla perben aktivitetin kryesor te prodhuesve, e cila u siguron punesim dhe te ardhura per familjet e me shume 7000 fermerve.

Problemi:

- Ne rajonin e Korces, paraqet risk evident demtimi i pemetoreve dhe i prodhimit nga renia breshherit.
- Demtimi nga bresheri ndikon ne shfaqjen e prodhimin periodik, sepse demton pemetoren, prodhimin dhe cilesine e tij.
- Prodhuessit nuk bejne rrallimin e frutave nga frika e breshherit, pema nuk perballon ngarkesen e prodhimit
- Cdo vit demtohen mbi 500 ha dhe mbi 20 mije ton prodhim te molles, per rrjedhoje kemi dem ekonomik dhe ulje te ardhurave te prodhuesve.
- Nuk ka instrumenta te mbrojtjes, sic eshte sigurimi i prodhimit etj.

Propozojme : instalimi i rrjetave antibresher ne pemetoret e molles nepermjet vendosjes se dy sistemeve te mbrojtjes antibresher dhe shoqerimi para dhe gjate vendosjes me assistance teknike te specializuar :

Varianti i pare, mbulimi i pemetores direkt me rrjete sipas rreshtave duke fiksuar rrjeten me disa aksesore, pa vendosjen e sistemit te shtyllave, i cili ka keto avantazhe ;

- Instalohet ne kohe te shpejte dhe lehte nga prodhuessit, mbi sistemin mbeshtetes ekzistues
- Kushton rreth 7000 €/ha ose 2 here me pak sesistemi klasik dhe paraqet leverdi eekonomike

Variant i dyte; mbulimi i pemetores me rrjete me sistem mbeshtetes dhe aksesore perkates

- Kerkon kohe per tu instaluar dhe grupe te specializuar te kompanive te prodhimit te sistemeve antibresher.
- Kerkon sistemi te ri mbeshtetes ne perputhje me teknologjine e instalimit te sistemit antibresher.
- Kushton rreth 17000 -20000 €/ha sipas llojit te cilesise se materialit qe perdoret.

Impakti:

- Mbron dhe garanton prodhimin, rrit cilesine e tij
- Heq stresin e prodhuesve, kryejne rrallimin e frutave dhe normalizon prodhimin
- Shmang prodhimin periodik.
- Siguron te ardhurat per fermeret

Shoqerimi me asistence te specializuar:

- Programe sensibilizimi dhe formimi gjate muajit qershor 2015 per domosdoshmerine e vendosjes se rrjetave antibresher (Validimi i tij me Sherbimin Bujqesor lokal e qendror (DBU Korce dhe MB)
- Formime ne teren me grupe pemtaresh duke filluar ne zonat me te riskuara dhe per te vazhduar ne gjithe rajonin e Korces.
- Shoqerimi i sensibilizim/trajnimimit me fiche teknike perkatese dhe me spote televizive ne TV- Korce.
- Ne baze te ketyre formimeve do te identifikohen ne teren nevojat per kete element shume te rendesishem te mbrojtjes se pemetoreve nga bresheri dhe mundesite e perfshirjes ne projekte ne forme individuale, grupi apo dhe organizate